

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDIN KOMUNAL TE DRAGASHIT

Për Aktivitetin e Prokurimit: 621-20-3171-5-2-1, nr. i brendshëm: 621-2020-073-5-2-1

Sa i përket tenderit: “Ndërtimi i objektit të qendrës së Mjekësisë familjare në fshatin Krushevë-
(projekt dy vjeçar)”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

PUNA Sh.p.k

(Emri i Operatorit Ekonomik)

Rr. Tahir Sinani, Blloku C2/B-Prizren

(Adresa)

Prizren,

(Vendi)

20000

(Kodi postar)

044 150 087

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vahidin Halili

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnp_puna@hotmail.com

(Adresa elektronike)

01.04.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



[Signature]
(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë: 24.06.2020 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 22.07.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 30.03.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Vendimi i OSHP-së nr.595/20 i dt.13.10.2020
Vendimi i OSHP-së nr.962/20 i dt.16.12.2020
Vendimi i OSHP-së nr.71/21 i dt.01.03.2021.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ju si autoritet kontraktues përsëri edhe pas rivlerësimit, në njoftimin mbi vendimin e dt.30.03.2021 e keni rekomanduar për kontratë OE "EBK SH.P.K", ndërsa ne jemi shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se "Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm, sepse në pozicionin: KALDAJA-NËNSTACIONI-pozicioni 3.1.12 nuk është plotësuar pozicioni për çmimin njësi (mungon çmimi); Sipas udhëzuesit Operativ neni 39.8-Mungon çmimi-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm".

Duke u bazuar edhe ne bazë të pyetjeve të shpeshta te cilat gjenden ne Web faqen e se:

29. Cila është procedura që duhet ndjekur në rast se Operatori Ekonomik vendos çmimin “0.00” euro në një nga artikujt/pozicionet (elementet përbërëse të tenderit)? (Referoju RRUOPP)

KRPP Një procedurë e tillë nuk është e rregulluar me dispozicionin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, megjithatë autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë si në vijim:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet e Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e plotë të kontratës.

Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin “0.00” në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në “Përshkrimin e Çmimeve” kërkohet të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artikull/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik.

Nëse Operatori Ekonomik plotëson në një nga pozicionet si: “gratis”, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë pranueshme.

Ju sqarojmë se arsyeja juaj për eliminimin tonë nuk qëndron për faktet si në vijim:

Në lidhje me pozicionin 3.1.12 ku për të cilin ju keni theksuar se nuk është vendosur çmimi ju sqarojmë se në këtë pozicion nuk është parashikuar të kryhet ndonjë punë apo furnizim i veçantë por është parashikuar të vendoset çmimi i pozicionit 1.16 dhe të nxjerret 50 % i këtij çmimi i dhënë në pozicionin 1.16, prandaj nëse shumëzohet $0.5 \times 112.00 \text{ €}$ atëherë del çmimi 56.00 €. Në këtë rast nuk është e vërtetë se ne nuk kemi dhënë në ndonjë pozicion çmim, por ju ri sqarojmë se në pozicionin 3.1.12 është

dashur vetëm të përshkruhet çmimi i pozicionit 1.16 dhe të nxjerret përlllogaritja e saktë e përqindjes duke e shumëzuar 0.5×112.00 €. Pra ky rast mund të llogaritet një gabim aritmetik nga ana jonë, por i cili nuk e kalon $\pm 2\%$ siç është e parashikuar në nenin 41.8 të RRUOPP-së. Gabimi ynë është aritmetik për faktin se ne në të gjitha pozicionet që janë kërkuar për të vendosur çmim kemi vendos çmim, mirëpo nuk është bërë përlllogaritja nga ana jonë, prandaj duke u bazuar në këtë fakt në momentin e përlllogaritjes së këtij pozicioni rezulton se diferenca e gabimeve aritmetike të jetë 100 euro, e cila është vlerë minimale dhe që nuk kalon 2 përqindëshin e gabimit aritmetik.

Referimi i juaj në nenin 39.8 të RRUOPP është plotësisht i gabueshëm dhe tendencioz sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me mungesë të çmimit dhe nuk është e vërtetë se ne nuk kemi ofruar çmim për njësi, sepse në të gjitha pozicionet kemi dhënë çmimi për njësi por është bërë një gabim aritmetikor i pastër sepse nuk kemi përlllogaritur 0.5×112.00 € që është çmimi i pozicionit 1.16, prandaj ky rast është plotësisht gabim aritmetikor dhe jo mos dhënie e çmimit në pozicione.

Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur shihet qartë se ne **nuk** kemi ofertuar me çmim 00.00 €, mirëpo që ka ndodhur një gabim në përlllogaritje, gabim ky i cili është tërësisht aritmetik, andaj dhe ju si AK është dashur të përmirësoni gabimin e bërë nga ana jonë dhe jo të na diskriminoni në këtë aktivitet të prokurimit duke na eliminuar edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Se ju është dashur ta përmirësoni gabimin e bërë nga ana jonë e parasheh qartë edhe neni 41.8 i RRUOPP-së pika i ku është e cekur shumë qartë “41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

i. Ne rast se shuma e korigjuar është me pak se $\pm 2\%$, AK do të përmirësojë gabimet e tilla dhe do të informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49. Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do të refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.” Ju si AK nuk i keni shfrytëzuar fare këto dispozita duke u munduar të na eliminoni nga ky aktivitet i prokurimit me arsye të cilat nuk qëndrojnë, pasi që është shumë e qartë se gabimi ynë është tërësisht aritmetik.

Ky rast s’ka të bëjë fare me pyetjen dhe përgjigjen e KRPP-së përkitazi me çmimet 00, prandaj edhe referimi i juaj në këtë pyetje është plotësisht absurd dhe nuk ka asnjë lidhshmëri ky rast me çmimet zero.

Se pretendimi ynë ankimor është i bazuar dhe qëndron e ka vërtetuar edhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së nr.962/20 i dt.16.12.2020, ku e ka cekur se për këtë pozicion nuk është kërkuar kryerja e ndonjë pune të veçantë por vetëm është parashikuar të shumëzohet 50% i pozicionit 1.16 dhe të nxjerret çmimi. Andaj duke u bazuar në vendimin e lartcekur të OSHP-së shihet qartë se arsyeja juaj për eliminimin tonë nuk qëndron, mirëpo ju si AK nuk e keni marr fare parasysh vendimin e lartcekur të OSHP-së, fakt ky që tregon qartë diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe vendimin e fundit të panelit shqyrtues me Nr.71/21 të dt.01.03.2021 ku në lidhje me këtë pretendim është konstatuar si në vijim:

Paneli Shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ankimor e ka obliguar autoritetin kontraktues që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së pasi që për pozicionin 3.1.12 nuk është kërkuar kryerja e ndonjë pune të veçantë por vetëm është parashikuar të shumëzohet me 50% e pozicionit 1.16 dhe të nxjerrët çmimi. Andaj, obligohet AK që të kërkojë sqarime shtesë dhe gjatë vlerësimit të vërtetohet nëse ka ndryshime më shumë se +/- 2%.

Ju si autoritet kontraktues përsëri keni vazhduar me procedura diskriminuuese ndaj neve dhe favorizuese ndaj OE të rekomanduar për kontratë sepse nga ne nuk keni kërkuar ndonjë sqarim përkitazi me çështjet që jeni obliguar nga AK-ja, ndërsa keni kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë edhe pse ky OE është shpallur i papërgjegjshëm edhe me vendimet paraprake të OSHP-së.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2, ku kërkesë ka qenë “Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga tri vitet e fundit”, ndërsa si dëshmi është kërkuar “Deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e shkuara”.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse nuk e ka ofruar deklaratën e lartcekur andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Në vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së nr.595/20 të dt.13.10.2020, në lidhje me pretendimin tonë të lartcekur, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-ja duhet të vërtetohet se a plotësohet kjo kërkesë e vendosur në njoftimin për kontratë dhe tek dosja e tenderit sipas nenit 9.1&9.2, nga ana e OE të rekomanduar për kontratë. Mirëpo edhe pse OSHP-ja ju ka detyruar juve të vërtetoni se a plotësohet kjo kërkesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, ju nuk e keni respektuar fare vendimin e lartcekur pasi që, nuk e keni vërtetuar fare se a plotësohet kjo kërkesë apo jo.

Gjithashtu në lidhje me pretendimin tonë të lartcekur, paneli shqyrtues i OSHP-së edhe në vendimin e nr.962/20 i dt.16.12.2020 ka konstatuar se ju si AK nuk e keni përfillur vendimin e OSHP-së nr.595/20 të dt.13.10.2020. Në vendimin e fundit të OSHP-së Nr.71/21 të dt.01.03.2021 është konstatuar se ju si AK keni kërkuar sqarime shtesë në lidhje me deklaratën e fuqisë punëtore dhe se OE i rekomanduar për kontratë ju ka ofruar një deklaratë, mirëpo deklarata e sjellur pas datës së hapjes së ofertave nuk duhet të merret parasysh sepse ky dokument mund të përpilohet edhe në ditën e dorëzimit, prandaj ky dokument nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive dhe për këtë arsye duhet të mos merret për bazë i njëjti dokument sipas nenit 72.3 të LPP-së.

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit me kohë, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm sepse sigurimi i tenderit të këtij operatori ekonomik ka shkëputje, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm, sepse shkëputjet siç e dijmë nuk janë të lejuara përderisa kërkohet të vazhdohet sigurimi i tenderit, atëherë vazhdimi i tij duhet të bëhet para datës së skadimit të sigurimit, mirëpo jo të bëhet dy-tri ditë pas datës së skadimit.

Faktin se pretendimi ynë ankimor i lartcekur është i bazuar e ka vërtetuar edhe vendimi i OSHP-së nr.962/20 i dt.16.12.2020, ku është cekur shumë qartë se vazhdimi i validitetit të sigurimit nuk duhet të ketë shkëputje, por të ketë vazhdimësi të validitetit. Mirëpo ju si AK nuk e keni respektuar vendimin e lartcekur të OSHP-së pasi që edhe përkundër faktit se ky OE është i papërgjegjshëm ju përsëri po e

rekomandoni për kontratë, duke e favorizuar haptas këtë operator ekonomik dhe njëkohësisht duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm.

Gjithashtu edhe vendimi i fundit i dt.01.03.2021 me nr.71/21e ka potencuar faktin e mos vazhdimit të validitetit me kohë dhe shkëputjen e validitetit, ndërsa në këtë vendim është konstatuar edhe njëherë se nuk bënë të ketë shkëputje të validitetit të tenderit. Citojmë konstatimin e fundit të panelit shqyrtues:

Pra, në pjesën e shkëputur të vendimit të cekur më lartë është sqaruar se vazhdimi i validitetit të sigurimit nuk duhet të ketë shkëputje por të ketë vazhdimësi të validitetit dhe ky pretendim ankimor ishte aprovuar si i bazuar. Andaj, Paneli Shqyrtues ri thekson se ky pretendim është i bazuar dhe nuk duhet të ketë shkëputje por të ketë vazhdimësi të validitetit.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka bërë gabim në përllogaritje sepse tek pozicioni 3.1.12, nuk e ka vendosur çmimin e pozicionit 1.16 siç është e kërkuar e që është dashur ta vendos çmimin 160.00 €, por ka vendos një çmim tjetër 117.50 € që ne nuk e dijmë ku e ka marr dhe ka bërë shumëzim 0.5 X 235.00 €, në mënyrë të gabueshme dhe jo siç është kërkuar në paramasë.

Në lidhje me këtë çështje ju i keni kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë, duke u munduar ta nxjerrni me çdo kusht si të përgjegjshëm, ndërsa ndaj neve tregoheni inferior dhe diskriminues duke mos shpreh asnjë interesim që të bëni rivlerësim të drejtë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Ne pajtohemi me arsyet e eliminimit që ju i keni dhënë në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar për OE “DAR ING” SH.P.K & “ENGRUP”, “ASTRAPLAN” SH.P.K & “U-Unique” SH.P.K, “Top Projekt” & Niki-GD, “AAG Projekt” SH.P.K & NNSH “REAL”, “RIDVAN ELEZI” B.I (ALFA- ING), “LIMITPROJECT” SH.P.K.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulet siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse e keni favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na keni diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues është dashur të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të

autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Ju si autoritet kontraktues jeni duke vazhduar me avazin e vjetër për diskriminim të kompanisë tonë dhe duke tentuar të na eliminoni me çdo kusht edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, por ju bëjmë me dije se ne nuk do të heqim dorë nga të drejtat tona ligjore, prandaj edhe këtë rast do të procedojmë në organet kompetente për shkelje të njëpasnjëshme të procedurave ligjore dhe për mos respektim të vendimeve të OSHP-së, ashtu siç e kemi proceduar edhe rastin e ujësjellësit.

Ju e keni dëshmuar se jeni mbi ligjin dhe shpeshherë e keni cekur edhe policinë e prokurorinë, e që faktikisht keni gjete mbështetje, mirëpo ne shpresojmë se një ditë do të vie momenti kur dikush do ti analizojë këto shkelje të juaja dhe të shkoni në përgjegjësi penale.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Puna" Shpk

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së, për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*